



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY  
Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383-38-548 644 URL: <http://www.fna.uni-pr.edu> Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 25/1 Prishtinë 06.01. 2023

**PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER**

**DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK**

Studenti Lumni Sallahu ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ Aplikimi i GIS-it për analizen e të dhënave për sistemin e kanalizimit për qytetin e Prizrenit ” në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**ABSTRAKT**

Përdorimi i sistemeve të informacionit gjeografik në menaxhimin e shërbimeve të ujërave të zeza ndikon në përmirësimin e shërbimeve përmes krijimit të kushteve lehtësuese në menaxhimin e sistemit të ujërave të zeza.

Meqenëse sistemi i ujërave të zeza për qytetin e Prizrenit është kompleks dhe si i tillë përbëhet nga objektet e ndryshme hidroteknike duke përfshirë: linja të kanalizimit, puseta, pusetat kaskadë, pikat kapërderdhësve të ujërave të zeza, pikave shkarkuese etj. Mbledhja e të dhënave për objektet e lartshënuara, përpunimi i tyre me anë të softuerëve të aplikueshëm krijon mundësi që analiza e të dhënave dhe prezantimi i rezultateve të jetë në kohë reale me një saktësi të madhe.

Çasja ndaj grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave hidroteknike dhe të integritetit të tyre kërkon profesionalizëm dhe përkushtim, duke u bazuar në këtë është krijuar strukturë organizative e cila paraqet grupet punuese dhe përshkrimin e punëve të këtyre grupeve me qëllim të zhvillimit të këtij studimi.

Monitorimi permanent i fazave të zhvillimit të studimit vlerësohet ndër pikat kyçe të aktiviteteve të këtij studimi, integrimi i të dhënave në sistemin e GIS-it për qytetin e Prizrenit dhe vektorizimi i tyre paraqet vazhdimësinë drejt objektivave të studimit.

Prezantimi i analizës së objekteve hidroteknike përmes sistemit GIS lehtëson të kuptuarit e zërave të performancës teknike të këtyre objekteve. Meqenëse të dhënat e objekteve hidroteknike janë pjesë statike dhe dinamike, pjesa e të dhënave dinamike kërkohet që të përditësohen në intervale të ndryshme kohore rrjedhimisht sipas kërkesave teknike apo kërkesave nga ofruesi i shërbimeve.

Identifikimi dhe kategorizimi i prioriteve për investim konsiderohet proces që në vete përmban sfida drejt zgjidhjes racionale përmes GIS-it dhe softuerëve të integruar brenda platformës lehtëson këtë proces rrjedhimisht vendimmarrjen e drejtë.

Posedimi i të dhënave të objekteve hidroteknike të sistemit të kanalizimit të integruara në GIS mundëson që në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës të prezantohen në gjeoportalin shtetëror të Republikës së Kosovës, në të cilën do të kenë çasje në informacion çdo individ apo grupet e interesit.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.